



REPUBLICA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

**DEKRET
PER
KTHIMIN E LIGJIT NR. 8869, DATE 21.03.2002
“ PER GARDEN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE ”**

Në mbështetje të nenit 85, pika 1, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Kthimin për rishqyrtim edhe një herë në Kuvend të ligjit nr. 8869,
datë 21.03.2002 “ Për Gardën e Republikës së Shqipërisë ”

Tiranë, më 06.04.2002
Nr. i dekretit: **3284**



**PRESIDENTI I REPUBLIKES
REXHEP MEIDANI**

Rexhep Meidani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

MOTIVIMI

I

**KTHIMIT TE LIGJIT NR 8869, DATE 21.03.2002
“ PER GARDEN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE”**

Të nderuar deputetë !

Në datë 29.03.2002 nga Kuvendi më ka ardhur për t’u dekretuar ligji nr. 8869, datë 21.03.2002 “ Për Gardën e Republikës së Shqipërisë ”, të cilin, pas disa konsultimeve të zhvilluara, vendosa të mos e shpall, por ta kthej edhe njëherë për shqyrtim në Kuvend.

1. Konstatoj se ligji i sipërcituar vjen ndesh me nenet 12 dhe 166 të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, shtetasit shqiptarë kanë për detyrë të marrin pjesë në mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë duke u përfshirë nën armë në strukturat e Forcave të Armatosura. Sipas nenit 11, pika 2, të ligjit që më ka ardhur për shpallje, rezulton se “gardistët përzgjidhen nga radhët e të rekrutuarve që kryejnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak....”

Në këto kushte, mendoj se është tejkaluar fryma e neneve 166 dhe 12 të kushtetutës, pasi këto dispozita, detyrojnë shtetasit të kryejnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak në mbrojtje të pavarësisë, tërësisë territoriale dhe të rendit kushtetues të Republikës së Shqipërisë vetëm në strukturat e Forcave të Armatosura. Sipas Kushtetutës, këto detyra janë ekskluzive për këto forca. Rezulton, se sipas nenit 2 të ligjit, Garda e Republikës është strukturë e Ministrisë së Rendit Publik, e në këto kushte gjykoj se shteti nuk mund të detyroj shtetasit të kryejnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak jashtë strukturave të Forcave të Armatosura.

Pavarësisht se shqetësimi i mësipërm ka gjetur rregullim në nenin 42 të ligjit, përsëri mendoj se nuk është i justifikuar qoftë edhe për periudhë kalimtare shkelja e frymës së Kushtetutës.

2. Vec sa më sipër, mendoj se ligji ka nevojë të rishqyrtohet edhe në dispozita të tjera të tij. Konkretisht:

2.1 Sipas nenit 10, pika 1, të ligjit “ Komandanti i Gardës.....përzgjidhet nga radhët e oficerëve madhorë të karrierës së Gardës, **të Ushtrisë** dhe të Policisë së Shtetit ”, dhe emërohet në detyrë nga Kryeministri me propozim të Ministrit të Rendit Publik. Ndërkohë, sipas nenit 7, pika 8, të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “ Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ”, oficerët me grada madhore, janë emërtesë e Presidentit të Republikës. Pra, jemi para një situatë ligjore që ka rregullime të ndryshme në dy ligje të vecantë.

2.2. Ligji përmban dispozita ligjore, zbatimin e të cilave kërkon nxjerrjen e akteve nënligjore, ndryshe ato mbeten vetëm deklarative. Sipas nenit 43, ngarkohet Këshilli i Ministrave që të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji, por konstatoj se për disa dispozita (nenet 36, 39) nuk është parashikuar një detyrim i tillë, sic përcaktohet edhe në nenin 118 të Kushtetutës.

Përsa më sipër, dhe duke shpresuar në mirëkuptimin Tuaj,

PRESIDENTI I REPUBLIKES
REXHEP MEIDANI



Rexhep Meidani